

PwC Albania

Tax Alert

For the month of August 2021



PwC Albania – Tax Alert

For the month of August 2021

Notice on the procedure of the fiscalization of import declarations

The General Tax Directorate notifies taxpayers the obligation to fiscalize the invoice, a procedure that must be completed no later than 3 days from the moment the goods are placed under the free circulation procedure by the Customs Authority.

Once the goods arrive at the border and the customs clearance procedure is completed, the customs authority issues the import VAT declaration, and sends all this information from the customs declaration to the information system of the Tax Administration.

The data included in the import declaration (as stipulated in the Instruction) will be transferred from the tax system to the Central Invoice Platform.

The importing taxpayer, in his user account on the Self-Care portal, under the category **Customs declaration**, will have to fiscalize the invoices for the imported goods.

In case the customs declaration needs to be revised, due to customs revaluation or post-clearance control, within the deadline specified in the customs code, the buyer who has completed the fiscalization process will immediately correct the invoice data on the central invoicing platform based on revised customs declaration.

Source: Notice from General Tax Directorate on the procedure of fiscalizing import declarations: [link](#)

Notice to taxpayers operating in the field of pharmaceutical products

Until the full implementation of the fiscalization system, all daily reports performed between the taxpayers "Pharmacies" and FSDKSH will continue to be performed as before through summary invoices, but provided that these summary invoices are fiscalized through a certified software solution.

Për muajin gusht 2021

Njoftim mbi procedurën e fiskalizimit të deklaratave të importit

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sjell në vëmendje të tatimpaguesve, detyrimin për të fiskalizuar faturën e importit të mallrave, procedurë e cila duhet të kryhet jo më vonë se 3 ditë nga momenti që mallrat vendosen nën procedurën e qarkullimit të lirë nga Autoriteti doganor.

Pasi mallrat vijnë në kufi dhe kryhet procedura e zhdoganimit, autoriteti doganor lëshon deklaratën doganore, të ngarkuar me TVSH në import dhe dërgon të dhënat nga deklarata doganore në sistemin e informacionit të Administratës Tatimore.

Disa nga të dhënat e deklaratës doganore, (të specifikuar në Udhëzim) do të transferohen nga C@TS në Platformën Qendrore të Faturave.

Tatimpaguesi importues, në llogarinë e tij të përdoruesit në portalin Self-Care, në kategorinë **Deklarata doganore**, do të duhet të fiskalizojë faturat për mallrat e importuara.

Në rast të rishikimit të deklaratës doganore, si rezultat i rivlerësimit doganor ose kontrollit të pas-zhdoganimit, brenda afatit të përcaktuar në kodin doganor, blerësi që ka përfunduar procesin e fiskalizimit do të korrigjojë menjëherë të dhënat e faturës në platformën qendrore të faturave bazuar në deklaratën doganore të rishikuar.

Burimi: Njoftim nga Drejtoria e Tatimeve mbi procedurën e fiskalizimit të deklaratave të importit: [link](#)

Njoftim për tatimpaguesit që operojnë në fushën e tregimit të produkteve farmaceutike

Deri në implementimin e plotë të sistemit të fiskalizimit të gjitha raportimet ditore të kryera ndërmjet tatimpaguesve "Farmacive" dhe FSDKSH do të vazhdojnë të kryhen siç janë kryer nëpërmjet faturave përmbledhëse, por me kusht që këto fatura përmbledhëse të jenë të fiskalizuara nëpërmjet një zgjidhjeje software-ike të certifikuar.

For the month of August 2021

As above, the summary invoices for July 2021, will be made only through certified software solutions for cashless transactions by August 10, 2021, unless the fiscalization process has not been implemented for independent reasons other than the taxpayer's.

Source: Notice from General Tax Directorate for pharmaceutical trade companies: [link](#)

Notice for taxpayers operating in the hydrocarbon trading sector

Taxpayers operating in the hydrocarbon sector and conducting activity in wholesale and/or retail trading, are notified that the documentation of the sale quantity of crude oil, petroleum products and GNL will be made only through the invoice issued in accordance with the law for the invoice and the turnover monitoring system.

Fiscalization of cashless invoices

Electronic invoices (e-invoices) paid by bank transfer are issued in all cases of wholesale supplies, i.e. initial sale of fuel coupon, sales with company cards and in all cases where the invoice is paid by bank.

In the case of a fuel coupon sale, taxpayers must issue an electronic invoice and fiscalize it the time the toll is issued.

If companies operating in the hydrocarbon market distribute cards for continuous fuel purchases, the confirmation of the total purchases is documented with a summary invoice issued for a period not exceeding a month.

When the supply of goods is paid with the taxpayer's company card, issued by the taxpayer who supplies the goods, the seller issues and fiscalizes the invoice and the buyer's identification information must be included in the invoice (NIPT, name and surname).

Fuel trading from customs/fiscal warehouses at retail centers, is carried out in each case through the issuance of an electronic invoice, which accompanies the transport of the fuel amount sold.

The fuel transporting company (transporter, buyer or seller), after leaving the customs/fiscal warehouse, is obliged to retain attached the electronic invoice the transport document identifying the fuel being transported.

Për muajin gusht 2021

Përsa më sipër, faturat përmbledhëse të muajit Korrik 2021, do të bëhen vetëm nëpërmjet zgjidhjeve software-ike për transaksionet pa para në dorë brenda datës 10 gusht 2021, me përjashtim të rasteve kur procesi i fiskalizimit nuk është zbatuar për shkaqe të pavarura nga tatimpaguesit.

Burimi: Njoftim nga Drejtoria e Tatimeve për tatimpaguesit në tregtimin e produkteve farmaceutike: [link](#)

Njoftim për tatimpaguesit që operojnë në sektorin e tregëtimit të hidrokarbureve

Tatimpaguesit që operojnë në sektorin e tregëtimit të hidrokarbureve me shumicë dhe/ose pakicë, njoftohen se dokumentimi i shitjes së sasisë së naftës bruto, produkteve të naftës dhe GNL do të bëhet vetëm me faturë të lëshuar në përputhje me ligjin për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit.

Fiskalizimi i faturave pa para në dorë

Faturat elektronike (e-fatura) pa para në dorë lëshohen në të gjitha rastet e funizimeve me shumicë: e shitja fillestare të tollonave, shitja me kartën e kompanisë dhe në të gjitha rastet kur fatura paguhet me bankë.

Në rastin e shitjes së tollonave, tatimpaguesi duhet të lëshojë faturat dhe t'i fiskalizojë ato në momentin kur lëshohet tolloni.

Nëse kompanitë që operojnë në tregun e hidrokarbureve shpërndajnë karta për blerje të vazhdueshme karburanti, dokumentimi i totalit të blerjeve behet me faturë përmbledhëse të lëshuar për një periudhë jo më të madhe se një muaj.

Kur furnizimi i mallrave paguhet me kartën e kompanisë të tatimpaguesit, të lëshuar nga tatimpaguesi që furnizon mallrat, shitësi lëshon dhe fiskalizon faturën dhe informacioni identifikues i blerësit duhet të vendoset në faturë (NIPT-i, emri/emri dhe mbiemri).

Tregtimi i karburanteve nga magazina doganore/fiskale në pikat e tregtimit me pakicë kryhet në çdo rast nëpërmjet lëshimit të një fature elektronike, e cila shoqëron transportin e sasisë së karburantit të shitur.

Subjekti transportues i karburantit (transportuesi, blerësi apo shitësi), pas daljes nga magazina doganore/fiskale, detyrohet të mbajë të bashkëngjitur me faturën elektronike edhe dokumentin e transportit që identifikon karburantit që po transportohet.

For the month of August 2021

Për muajin gusht 2021

Fiscalization of cash sales of fuel

For retail sales carried out to the final consumer, an invoice must be issued and fiscalized containing all the elements set out in Law no. 87/2019 “On the invoice and the turnover monitoring system”, amended (hereinafter “the Law”).

Existing fiscal devices are intended for issuing invoices only for cash transactions. The coupon issued by these devices does not replace the tax invoice and should not be confused with the electronic invoice (e-invoice).

Referring to the above, retail fuel trading companies may choose to continue cooperating with companies that have already provided them with a fiscal device and ensure that the equipment is fiscalized and meets the conditions for the Fiscalization, or otherwise choose to connect the electronic fuel system with a new certified software solution for documenting cash transactions.

Under these conditions, all fuel retail chains must be equipped with dispensers that operate only under automatic modality and under the fiscal system control (consisting of the electronic dispenser controller and the fiscal device) necessarily connected to a certified software solution.

Every fuel dispenser, including those of GLN, must be connected to the aforementioned fiscal system. Fuel supply must be connected to the automatic registration of sales and must work under the mandatory rule "NO INVOICE, NO FUEL".

Source: Notice from General Tax Directorate for taxpayers operating in the hydrocarbon sector: [link](#)

Fiskalizimi i shitjeve të karburantit me para në dorë

Për shitjet me pakicë të kryer për një konsumator final, një faturë duhet të lëshohet dhe fiskalizohet dhe të përmbajë elementët e përcaktuar në Ligjin Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar (më tej “Ligji”).

Pajisjet fiskale ekzistuese, janë të destinuara për lëshimin e faturave vetëm për transaksione që kryhen me para në dorë. Kuponi i lëshuar nga këto pajisje nuk zëvendëson faturën tatimore dhe nuk duhet të konfundohet me faturën elektronike (e-invoice).

Referuar sa më sipër, shoqëritë e tregtimit të karburanteve me pakicë mund të zgjedhin të vijojnë bashkëpunimin me shoqëritë që i kanë pajisur me kasë fiskale dhe të sigurohen që pajisjet janë të fiskalizuara dhe përmbushin kushtet e Fiskalizimit, ose të zgjedhin të lidhin sistemin elektronik të karburantit me një zgjidhje të re softwerike të çertifikuar për dokumentimin e transaksioneve me para në dorë.

Në këto kushte, të gjitha pikat e shitjes me pakicë të karburanteve duhet të pajisen me dispensera që operojnë vetëm nën regjimin automatik dhe nën kontrollin e sistemit fiskal (i përbërë nga kontrolleri i dispenserit elektronik dhe pajisja fiskale) të lidhur detyrimisht me një zgjidhje software-ike të çertifikuar.

Çdo dispenser i karburantit, përfshirë dhe ata të GNL, detyrimisht duhet të jetë i lidhur me sistemin fiskal të sipërpërmendur. Furnizimi me karburant duhet të jetë i lidhur me regjistrimin automatik të shitjeve dhe duhet të punojë nën rregullin e detyrueshëm “PA FATURË, S’KA KARBURANT”.

Burimi: Njoftim nga Drejtoria e Tatimeve për tatimpaguesit në sektorin hidorkabur: [link](#)



Let's talk!

For further information, please contact:

PricewaterhouseCoopers Albania
Str. "Ibrahim Rugova", Sky Tower, 9/1

Telephone: +355 4 22 90 700

Email: al_pwc_albania@pwc.com

Web: www.pwc.com/al

